

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përberë nga Kryetari i Gjykatës Salih Mekaj, kryetar kolegji, Mejreme Memaj e Fllanza KAiu, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shaqë Curri, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve **F.Sh.**, nga fshati ..., komuna e Suharekës, **E.K. e A.K.**, që të dy nga Suhareka, rruga "...", p.n., për shkak të veprës penale vrasje, parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës(KPK), **E.K.**, nga Suhareka, rruga "...", p.n., për veprat penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 5 të KPK dhe lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me 1 pika 4 të KPK, **M.K. e F.K.**, që të dy nga Suhareka, rruga ..., p.n., për veprën penale lëndimi rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, **Nj.K.** për shkak se si bashkëzekutor me F.K. për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me par.1.4 dhe nenin 23 të KPK, **D.K.**, për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.1 pika 1 të KPK, **I.Sh.**, nga fshati komuna e Suharekës, për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.1 pika 4 të KPK, dhe **J.K. e B.Sh.** për veprën penale e pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, atë të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit N.K., mbrojtësve të të pandehurve F.Sh., E.K., A.K., E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh., J.K. e B.Sh. dhe përgjigjes së mbrojtësve të të pandehurve Ar. e E.K. dhe A.K. në ankesën e Prokurorit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.11/2013 datë 11.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale(KPP), me 25 shkurt 2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Ankesat e mbrojtësve të pandehurve F.Sh., E.K. e A.K. aprovohen si të bazuara, dhe aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.11/2013 datë 11 shtator 2014 përkitazi me këta të pandehur anulohet dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, por, një kolegji tjetër.

II. Ankesa e Prokurorit dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar sa i përket këtyre të pandehurve përkitazi me vendimin për dënim tani për tani është jolëndore.

III. Ndaj të pandehurve F.Sh., E. e A.K. vazhdohet paraburgimi.

II. Ankesat e mbrojtësve të të pandehurve E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh., J.K. e B.Sh. dhe ajo e Prokurorit për dënimin përkitazi me këta të pandehur refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i lartcekur në këtë pjesë vërtetohet.

III. Ankesa e Prokurorit në pjesën liruese nën pikën III të dispozitivit të aktgjykimit refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi në pjesën refuzuese nën pikën II të dispozitivit ngel i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me aktakuzën e Prokurorit Themelor në Prizren PP.nr.231/2012 datë 4.08.2012, të pandehurit F.Sh., J.K., E. e A.K., janë akuzuar se si bashkekzekutor kanë kryer veprat penale vrasje, parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të KPK dhe veprën penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, E.K. për shkak të dy veprave penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 5 të KPK, M.K. e F.K., për veprën penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 5 të KPK, Nj.K.. e F.K., për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par. 2 lidhur me par.1 pika 4 dhe nenin 23 të KPK, D.K., për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK, I.Sh. për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK, te pandehurit A.K., N.K., B.K., B.K.1. e B.Sh. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin P.nr.11/2013 datë 11 shtator 2014, të akuzuarit F.Sh., E.K. e A.K. i ka shpall fajtor për shkak se si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale vrasje, të parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të KPK; E.K.n për veprat penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 5 të KPK dhe lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK; M.K.n e F.K.n për shkak të veprës penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK; Nj.K.n e F.K.n për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 dhe nenin 23 të KPK; D.K.n për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.1 pika 1 të KPK, I.Sh. për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 153 par.1 pika 4 të KPK dhe J.K.n e B.Sh për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 të KPK. I ka gjykuar F.SH. me 15(pesëmbëdhjetë)vite burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 2.08.2012 e tutje. E.K.n e A.K.n secilin me nga 13(trembëdhjetë) vite burgim, në të cilat u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 11.09.2014 e tutje. E.K.t e F.K.t pasi që ua ka caktuar dënimet me burgim për dy veprat penale dhe atë për veprën e parë dënimin me 2(dy) vite burgim, për veprën e dytë 8(tetë) muaj burgim, konform dispozitës së nenit 80 të KPK i ka gjykuar me dënim unik me burgim me nga 2(dy) vite e 6(gjashtë) muaj. Në dënim e shqiptuar me burgim të pandehurit E. i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 2.08.2012 deri me 13.09.2012. Të pandehurin M.K. e ka gjykuar me 2(dy) vite burgim, të pandehurit Nj.K.. e D.K. me nga 8(tetë) muaj burgim. I.Sh. e B.Sh me nga 1(një) vit burgim, kurse J.K.n me 6(gjashtë) muaj burgim. Te dëmtuarit V.K., përfaqësuesi ligjor i të miturit E.K., Z.K. për

realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Të pandehurit janë obliguar të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës penale dhe atë për 11 ekspertiza mjeko ligjore në shumë prej 224.84€, për ekspertizën mjeko ligjore të Dr.F.B. 40€, për super ekspertizën 20€ dhe paushallin gjyqësor secili nga 400€. Me të njëjtin aktgjykim konform dispozitës së nenit 364 par.1 nenpar.1.3 të KPP të akuzuarit F.Sh., E.K. e A.K. janë liruar nga akuza për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, te akuzuarit A.K., B.K.1. e B.K. për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK, për shkak se nuk është provuar se i kanë kryer keto vepra penale. Kurse konform dispozitës së nenit 363 par.1 nenpar. 1.1 të KPP ndaj të akuzuarit J.K. është refuzuar akuza për shkak të veprave penale vrasje, parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të KPK dhe lëndim i rëndë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK dhe N.K.t për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK për shkak se ka hequr dore Prokurori nga ndjekja penale. Shpenzimet e procedurës penale përkitazi me pjesën refuzuese dhe liruese i janë ngarkuar mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në pjesën gjyqësore kanë ushtruar ankesa:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, në pjesën gjyqësore, për shkak të vendimit për dënim, kurse në pjesën liruese për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën gjyqësore përkitazi me të pandehurit F.Sh., E.K., A.K., E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh., J.K. e B.Sh. për veprat penale për të cilat janë shpall fajtor të ndryshohet ashtu që ndaj të pandehurve të shqiptohen dënime me të larta me burgim, kurse në pjesën liruese përkitazi me të pandehurit F.Sh., E.K., A.K., A.K., B.K.1. dhe B.K. të anulohet dhe në këtë pjesë çështja të kthehet në rigjykim apo të ndryshohet ashtu që të pandehurit Fa., E. e Ar. të shpallën fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 23 të KPK, kurse të akuzuarit A., Be. e B.K. të shpallen fajtor për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 par.1 të KPK dhe për këto vepra penale tu shqiptohen dënime konform dispozitave ligjore;

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar N.K., avokati H.K., për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi I kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të pandehurit F.Sh., E.K. e A.K. tu shqiptohen dënime me të ashpra apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së pare për rigjykim;

Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh., avokati E. R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi I kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së pare për rigjykim ose të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza për veprën penale për të cilën është shpall fajtor apo ndaj tij të shqiptohet dënim me i butë;

Mbrojtësi e të pandehurit E. e A.K. avokatët K.K. dhe R.D. (ankesë të përbashkët), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa të aprovohet

aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet ashtu që të pandehurit të lirohen nga akuza për veprën penale për të cilën janë shpall fajtor dhe tu ndërpritet paraburgimi;

Mbrojtësi i të pandehurit E.K., avokati D.F. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet sa i përket vendimit për dënim ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim me i butë;

Mbrojtësi i të pandehurit M.K., avokati N.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza ose të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim;

Mbrojtësi i të pandehurit F.K., avokati H.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza apo ndaj tij të shqiptohet dënim me i butë apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Mbrojtësi i të pandehurit Nj.K., avokati E.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Mbrojtësit e të pandehurit D.K. (ankesa të veçanta), avokatët O.Z. e S.Z. (ky i fundit i angazhuar në fazën ankimore), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Mbrojtësi i të pandehurit I.Sh., avokati S.H., për të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Mbrojtësi i të pandehurit J.K., avokati A.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim apo ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza;

Mbrojtësi i të pandehurit B.Sh. avokati Q.Xh., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza apo ndaj tij të shqiptohet dënim me i butë apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Kurse, ndaj ankesës së Prokurorit janë përgjigjur:

Mbrojtësit e të pandehurve E. dhe A.K. me propozim që ankesa e Prokurorit të aprovohet,

Mbrojtësi i të pandehurit A.K. avokati N.B., me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi në pjesën liruese sa i përket të mbrojturit të tij të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP për të cilën i njoftoi palët. Në seancë prezantuan Prokurori Apelit Haxhi Derguti, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar avokati H.K., i dëmtuari N.K., të dëmtuarat V.K. dhe Z.K., të akuzuarit F.Sh., E.K. e A.K., mbrojtësit e tyre avokatet E. R., K.K. dhe R.D., të akuzuarit D.K., M.K., Nj.K.. e A.K., dhe mbrojtësit e tyre avokatet S.Z., N.Q., E.G., N.B.. Në seancë munguan të akuzuarit E.K., F.K., I.Sh., B.Sh. dhe J.K. të cilët janë njoftuar me rregull, por në seancë prezantuan mbrojtësit e tyre avokatet D.F., H.S., S.H., Q.Xh., A.J.. Prokurori i Apelit mbështeti propozimin e bërë me shkrim PPA/I.nr.591/14 datë 10.12.2014, me të cilin ka propozuar që ankesa e Prokurorit të miratohet, aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën liruese të ndryshohet ashtu që të pandehurit F.Sh., E.K. e A.K., Fa., E. e Ar. të shpallën fajtor për veprën penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 23 të KPK, kurse të akuzuarit A., Be. e B.K. të shpallen fajtor për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 par.1 të KPK dhe ndaj tyre të shqiptohet dënim konform dispozitave ligjore, kurse ankesat e mbrojtësve të të pandehurve F.Sh., J.K., E.K., A.K., E.K., D.K., M.K., F.K., Nj.K., B.Sh. e I.Sh. të refuzohen si të pabazuara. Mbrojtësit e të pandehurve pasi që sqaruan disa nga pretendimet ankimore në ankesa mbështeten propozimet e bëra në to, kurse të pandehurit e pranishëm mbështeten mbrojtësit dhe ankesat e mbrojtësve të tyre.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penalo-juridike, e studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, konstatoi se:

-ankesat e mbrojtësve të të pandehurve F.Sh., E. e A.K. janë të bazuara, ankesa e Prokurorit dhe ajo e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar për dënimin për këta të pandehur për tani është jolëndore, kurse ankesat e mbrojtësve të të pandehurve E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh., J.K. e B.Sh. dhe ajo e Prokurorit për dënimin përkitazi me këta të pandehur dhe ankesa e Prokurorit për pjesën liruese nuk janë të bazuara.

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pjesën gjykuese sa i përket të pandehurve F.Sh., E.K. dhe A.K.

Nga shkresat e lëndës nuk dalin kontestuese këto rrethana:

Se ngjarja tragjike ka ndodh me 2.08.2012, rreth orës 16 e 30 min., në rrugën "...", përballë shtëpisë së N.K.t e J.K.t; të gjithë të pandehurit e involvuar në këtë ngjarje janë në raporte të ngushta familjare. E.i, E.i, Ar.i, D e A.i janë djemtë e J.K.t. Me., Fi., Ni., Bl. e Be.u djemtë e N.K.; Nu. e Jo. janë vëllezër, bashkëshortet e tyre janë motra, kurse I.Sh. është miku i tyre, përndryshe vëllai i bashkëshortëve të Nu.t e Jo.t. Fa.i është djali i Iz., kurse Ba. e ka djalë të axhës. Si shkas i kësaj ngjarje është mos pjesëmarrja e familjes së Jo.t dhe I.Sh. në dasmën e djalit të Nu.t dhe provokimit të dasmorëve nga familja e Iz. dhe Jo.t sipas thënieve të N.K.t. Pas dasmës, të nesmren N.K. nëpërmjet I.Sh. - kushëririt të bashkëshortes së tij dhe njërit nga djemtë e tij i dërgon porosi Iz. "që të mos vjen se po provokon dhe puna do të behet keq". Edhe pse, sipas dëshmisë së I.Sh. në momentin kur ia kishte dërguar porosinë Iz. kanë qenë prezent Fa.i e Ba., pas dërgimit të kësaj porosie pas dy tri orëve në shtëpinë e J.K.t shkon B.Sh.. Meqë, djemtë e Nu. e shohin Ba. vjen deri të një konflikt verbal në mes tyre. Djemtë e Nu. mbi murin që ndan oborret e shtëpisë së Nu. dhe Jo. i thonjë Ba. "se pse ke ardhë këtu dhe puna do të behet keq", por, që situata qetësohet. Rezulton se ngjarja tragjike ndodh pas ardhjes së I.Sh. me djalin e tij Fa. dhe përleshjes fizike fillimisht në mes të M. e Fi.t (djemve të Nu.t të cilët qëndronin në shitoren e tyre) dhe Iz. e Fa. Në këtë përleshje involvohen edhe të tjerët mAjë edhe gratë. Gjatë përleshjes fizike si pasojë e lëndimeve të pësura humb jetën djali i N.K. B.K. dhe të pandehurit i shkaktojnë lëndime njeri- tjetrit.

Përkitazi me këtë ngjarje tragjike, sipas aktgjykimit të kundërshtuar të pandehurit **F.Sh., E.K. e A.K.** shpallen fajtor për veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje, nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK ashtu siç janë ngarkuar me akuzë. I pandehuri **E.K.** për veprën penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par.1 pika 5 të KPK të kryer në dëm të të pandehurit Nj.K., dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK të kryer në dëm të të pandehurit F.K.. Të pandehurit **M.K. e F.K.** për veprën penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK të kryer në dëm të të pandehurit I.Sh.. I pandehuri **Fi.** edhe për shkak se si bashkëkryesor me të pandehurin **Ni.** kanë kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 dhe nenin 23 të KPK në dëm të të pandehurit F.Sh.. I pandehuri **D.K.** për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.1 pika 1 të KPK, të kryer në dëm të M.K.. I pandehuri **I.Sh.**, për veprën penale lëndim i lehtë trupor, por të kryer në dëm të të dëmtuarës Z.K.. Kurse, të pandehurit **J.K.**(ndaj të pandehurit J.K. Prokurori heq dorë nga ndjekja penale për veprën penale të vrasjes dhe e akuzon vetëm për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje), **e B.Sh.** për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 par.1 të KPK. Të pandehurit F.Sh., E.K., A.K., lirohen nga akuza për veprën penale lëndim i rëndë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 të KPK të kryer në dëm të fëmijës E.K., kurse A.K., B.K. e B.K.1. për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me veprën penale të Vrasjes kjo Gjykatë vlerëson se ankesat e mbrojtësve të të pandehurve F.Sh., E.K. e A.K. janë të bazuara, dhe se aktgjykimi në këtë pjesë duhet anuluar.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i kundërshtuar përkitazi me veprën penale të vrasjes për tani është i paqëndrueshëm sepse përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPP, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, në arsyetim nuk janë paraqit arsye mbi faktet vendimtare, ekziston kundërthënie e konsiderueshme midis asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, kurse as gjendja faktike në këtë pjesë të çështjes penale nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë siç me të drejtë pretendojnë mbrojtësit në ankesa.

Kështu, në dispozitivin e aktgjykimit nën pikën I nder të tjera është theksuar "...pas përleshjeve fizike masive dhe të dhunshme të pjesëmarrjes se tri familjeve, E.K. i pajisur me një hu druri i afrohet të dëmtuarit B.K., i cili ishte para shkallëve të shtëpisë se tij dhe të njëjtin e godet me një hu në kokë, pikërisht në regjionin e veshit të djathtë dhe gjersa i dëmtuari fillon të rrezohet i afrohet edhe i akuzuari F.Sh. i pajisur me një dru të gjatësisë për afërsisht një metër dhe e godet të dëmtuarin tani të ndjerin Burim në kokë pikërisht në tepin e kokës, dhe kur i dëmtuari fillon të dridhet dhe rrezohet për tokë duke humbur vetëdijen, duke qenë i shtrirë ashtu i afrohet edhe i pandehuri Ar. dhe i thotë " nëse nuk të vras ktu kom me të vra në Itali", dhe me një shufër metalike e godet të dëmtuarin tani të ndjerin në kokë, kështu që të ndjerit Burim i shkaktojnë lëndime trupore, si thyerje e ashtit ballor të djathtë, ashtit tamthor të djathtë, ashtit zverkor dhe çatisë se orbitës me dëmtime të trurit të shoqëruara me gjakderdhje në zona të ndryshme trunore që kanë ardh si pasojë e thyerjeve të shumta të kafkës, i ndjeri si pasojë e goditjeve të marra me datën 9.08.2012 vdes në QKUK në Prishtinë"

Fillimisht, vlen të theksohet se në dispozitiv të aktgjykimit nuk ceket se të pandehurit kanë vepruar me dashje për ta privuar nga jeta të ndjerin, element subjektiv i kësaj vepre penale, e pa të cilin nuk mund të ekzistojë kjo vepër. Pastaj, përderisa, në dispozitiv theksohet se të pandehurit me mjetet e lartcekura e kanë goditur të ndjerin nga një herë në kokë, dhe nga ato goditje i ndjeri ka pësuar lëndime të shumta –thyerje të shumta të kafkës, si pasojë e të cilave vdes, arsyet e dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me këtë konkludim nuk mund të aprovohen si të drejta dhe të ligjshme, ngase nuk kanë mbështetje në provat e Aministruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kështu, sipas raportit të autopsisë të bërë nga Dr.F.B. nuk rezulton kontestues fakti se vdekja e të ndjerit ka qenë e dhunshme, si pasojë e dëmtimit të trurit e shoqëruar me gjakderdhje në zonat e ndryshme trunore, që janë rrjedhojë e thyerjeve të shumta të kafkës nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë). Mirëpo, në shqyrtimin gjyqësor ky ekspert ka deklaruar: i ndjeri ka pësuar disa dëmtime, plagë shqyese në regjionin ballor të kokës, ana e djathtë, mavijosje apo gjakderdhje nën lëkurore në anën e djathtë në regjionin ballor, mbi rrënjën e hundës, në hundë, në të dy anë e buzës së poshtme, mbi veshin e djathtë, në mollëzën e majtë të fytyrës, në anën e djathtë të qafës, në pjesën e pasme të kokës, tri në regjionin zverkori të cilat janë dëmtime lëkurore, gjatë

ekzaminimit të jashtëm. Kurse, thyerjet e kafkës janë: ashti ballor i djathtë, ashti temthor i jashtëm, ashti zverkor, çatia e orbitës, maksilla, kurse dëmtimet në tru janë gjakderdhje brenda trunore në pjesë të të ndryshme të trurit. Të gjitha këto dëmtime nuk ka qenë e mundur të jenë shkaktuar nga veprimi vetëm i një mjeti të fortë, me besueshmëri të lartë shkencore duhet të kenë qenë me shumë. Lloji i mjetit nuk ka mund të përcaktohet sepse i ndjeri ka qëndruar i shtrirë një javë në Qendrën Klinike dhe një pjesë e plagëve është shëruar. Kurse, edhe goditja vdekjeprurëse është vështirë të përcaktohet sepse goditja pasuese e ka ndihmuar thyerjen e një pjesë të kafkës dhe është logjike se disa prej goditjeve në kokë kanë vepruar në mënyrë kumulative dhe kanë ndikuar jo vetëm në thyerje të kafkës por edhe në gjakderdhje trunore. Janë 10 dëmtime në regjionin e kokës dhe nuk përjashtohet mundësia që në një regjion të caktuar në një dëmtim të caktuar të ketë pasur me shumë se një goditje. Pastaj, eksperti përkritazi me konstatimin e bërë në fletshimin me epikrizë të QKU në të cilin thuhet thyerje e kockave në regjionin ballor dhe bazal të kokës si thyerje zhytëse pra, depresiva, ka theksuar se kjo nënkupton se copat e kockave kanë qenë brenda, dhe kjo thyerje mund të jetë bërë nga çekani, druri, por jo edhe nga grushti, dhe meqë thyerjen zhytëse nuk e ka konstatuar gjatë autopsisë nuk mund të thotë me saktësi nëse ajo thyerje është shkaktuar me çekiç, por, ka mundësi.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, meqë eksperti i mjekësisë ligjore i cili e ka bërë autopsinë e të ndjerit në shqyrtimin gjyqësor nuk i ka përcaktuar mjetet me të cilat është goditur i ndjeri, nuk e ka përcaktuar goditjen me pasoja fatale, nuk e ka përjashtuar mundësinë që plaga zhytëse të jetë shkaktuar me çekan të cilin mjet siç rezulton nga provat e Administruara nuk e kanë pas fare në dorë të pandehurit, nuk e ka përjashtuar mundësinë që vetëm në një regjion të caktuar në një dëmtim të caktuar të ketë pas me shumë se një goditje, për këtë Gjykatë nuk është e qartë se në çka e ka mbështet gjykata e shkallës së parë konkludimin e saj se të pandehurit me mjetet të cilat theksohen në dispozitiv me nga një goditje t'ia kanë shkaktuar të ndjerit të gjitha dëmtimet të cilat i ka theksuar eksperti, e si pasojë e këtyre goditjeve ka vdekur. Për të evituar këto dilema gjykata nuk është dashtë ta refuzoj kërkesën e mbrojtëses se të pandehurit Ar. për super ekspertizë në këtë drejtim, sepse, nga këto rrethanë varet jo vetëm zbardhja e rrjedhjes së ngjarjes, por edhe aplikimi i drejtë i ligjit penal, si nga aspekti objektiv i veprës ashtu edhe në aspektin subjektiv. Në fakt, gjykata e shkallës së parë vetëm përshkruan mendimin e ekspertit mjeko ligjor të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, por, në arsyetimin e aktgjykimit jo vetëm që nuk jep asnjë arsye apo vlerësim se perse e ka konsideruar mendimin dhe konstatimin e tij si zgjidhje reale të çështjes, ajo, nuk jep arsye as perse e ka refuzuar propozimin e mbrojtëses për super ekspertizë.

Përveç, kësaj, përkritazi me veprimet e të pandehurve E. e Ar. në momentin kritik dhe mjetet të cilat i kanë përdorë në ndërmarrjen e veprimeve ndaj të ndjerit, provat janë kontradiktorë, kurse, gjykata nuk ka dhënë arsye përkritazi me saktësinë e kundërthënieve të tyre, kurse disa as që i ka vlerësuar fare. Kështu, gjykata e shkallës së parë konkludimin se të pandehurit E. e Ar. i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese sikurse në dispozitiv të aktgjykimit e mbështet në dëshminë e dëshmitarëve V.K. (bashkëshortja e të ndjerit), K.K., Gj.K., Z.K.t, mbrojtjen e të pandehurve M., B. e B.K.1.t dhe deklaratën e N.K.t (babait të ndjerit) të dhëna në shqyrtimin gjyqësor. Mirëpo, deklaratat e dëshmitarëve (K.K. që është

dëgjuar vetëm në shqyrtimin gjyqësor) dhe mbrojtjet e të pandehurve të dhëna në hetime ndryshojnë shumë sa i përket veprimeve që i kanë ndërmarrë këta të pandehur në momentin kritik. Kështu, në deklaratën e tij të dhënë në hetime menjëherë pas ngjarjes N.K. (4.08.2008) ka deklaruar “ E. ka pas në dorë dru. Ar. ka pas në dorë dru dhe ka sjell por nuk ka pa se kë ka godit”. Bashkëshortja e të ndjerit ka theksuar se ka pare kur E.i e ka godit me një mjet të gjatë në dorë bashkëshortin e saj, por nuk e din se mjeti ka qenë i drurit apo i hekurt, por nuk thekson se ka pare Ar. M. thekson se E. e ka mbajtur Nj. të cilin e ka godit me grusht, kurse Fi. thekson se përpos Jo.t, Fa.it e Ar.it të cilët e kanë godit të ndjerin, në afërsi të ndjerit ka qenë edhe E. por ai e ka goditur me shqelma në trup, ndërsa, sipas ekspertit të autopsisë rezulton se i ndjeri nuk kishte lëndime në trup. Nj. deklaron se pasi që Burimi është rrezua e kanë goditur E. e Ar. Bl. thekson se e di që E. ka mbajtur vëllain tim e me pas e ka godit me dru dhe po ashtu kam vërejtur momentin kur Fa. me një dru në dorë me gjithë forcë e ka godit vëllain tim B. i cili ka ra menjëherë në tokë, por, në deklaratën e tij të dhënë me 5.09.2012 thekson se dua të shtoj “se pos Fa. vëllain tim të ndjerë e ka goditur edhe Jo.. Jo. e ka goditur para Fa.it me çekan, pas tij E. me hu, pastaj e ka godit Fa. dhe nga ajo goditje është rrezua, ndërsa, derisa ka qenë i shtrirë e ka godit Ar.”. Be. potencon vetëm Fa.in si person që e ka goditur vëllain e tij, ndërsa, nena e të ndjerit –dëshmitarja Z.K., në hetime nuk ka theksuar fare që Ar. e ka godit të ndjerin, në fakt ajo në këtë drejtim thekson kam dëgju përçartë kur Ar. është afruar dhe i ka thënë “se mos vdeksh ktu kam me të mbyt në Itali”. Pastaj, Gjykata në arsyetim të aktgjykim thekson se gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të aktgjyqimit e mbështet edhe në dëshminë e dëshmitares P.K. (motra e të ndjerit e cila sipas deklaratave të të gjithë të pandehurve ka qenë në vendngjarje), deklarata e të cilës rezulton se me pëlqimin e palëve është lexuar në shqyrtimin gjyqësor (në fakt kjo deklaratë nuk gjendet në shkresat e kësaj çështje), por askund në arsyetim me asnjë fjali nuk arsyetohet dëshmia e kësaj dëshmitareje.

Konform dispozitave ligjore e drejtë e Gjykatës është që të vlerësojë ekzistimin ose mosekzistimin e fakteve, dhe në këtë drejtim ajo nuk është e kufizuar me rregulla formale. Por, konform dispozitave ligjore nenit 370 par.7 të KPK është detyrë e Gjykatës të paraqes qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, dhe në mënyrë të veçantë duhet të vlerësoj saktësinë e provave kundërthënëse. Në fakt gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas kësaj dispozite, ajo vetëm ka cituar thëniet e tyre të cilat mAjë e bëjnë arsyetimin kontrAiktor më dispozitivin. Kështu, gjykata në arsyetim thekson” edhe për të akuzuarit E. e Ar. gjendja faktike u vërtetua duke i analizuar të gjitha provat materiale si dhe deklarata e disa dëshmitarëve V.K., kur deklaron “se e kam pa E.in duke e godit burrin tim”, ndërsa, dëshmitarja Ka. kur thotë se “E.i ka patur drurin, kur Fa. e godet B. , aty për rreth ka qenë Ar. e E.”, pastaj i akuzuari M.K. kur thotë se “E. e ka goditur B. në kokë 2-3 herë, e pastaj është rrëzua për tokë, pastaj Ar. me hebell dhe i është drejtuar me fjalët nëse nuk të mbysh këtu, kamë me të mbytë në Itali, ndërsa, deklarata me bindëse ishte ajo e të akuzuarit B. kur thotë se E.i nuk e lëshonte drurin prej dore i cili ka qenë i gjatë diku 1.5 m...etj.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate deklarimet e tilla kontradiktore nuk paraqesin prova të besueshme për vërtetimin e veprimeve të të pandehurve ashtu siç theksohet në

dispozitivin e aktgjykimit, dhe bëjnë që aktgjykimi të jetë i paqartë dhe juridikisht i paqëndrueshëm për vlerësim të mëtejshëm.

Nga, shkeljet esenciale të lartcekura rezultojnë se gjykata nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Në fakt gjykata nuk ka bërë përpjekje ta ndriçojë të vërtetën përkitazi me këtë pjesë të çështjes, ngase faktet vendimtare të theksuar me lartë - mendimin dhe konstatimin e ekspertit të autopsisë, dëshmitë e dëshmitarëve dhe mbrojtjet e të pandehurve nuk i ka vlerësuar drejt në drejtim të rrethanave të lartcekura.

Duke pas parasysh qëndrimin e kësaj Gjykate lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar, si dhe vërejtjet e mbrojtësve të të pandehurve për ekzistimin e arsyeve për përjashtimin e kryetarit të trupit gjykues, kjo Gjykatë ka vlerësuar se për evitimin e çfarëdo konflikti të interesit dhe mundësisë së zvarritjes së procedurës përmes kërkesave për përjashtim të trupit gjykues është e nevojshme që në përfundim me nenin 398 par.2 të KPP të urdhërohet caktimi i një trupi tjetër gjykues.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë shkeljet e lartcekura, të urdhërojë super ekspertizë nga një grup i eksperteve të mjekësisë ligjore të cilët duke pas parasysh shkresat e lëndës, posaçërisht raportin e autopsisë, lëshimin me Epikrizë të QKU duhet të përcaktojnë mjetet me të cilat është goditur i ndjeri, cila goditje ka qenë vdekjeprurëse, të deklarohen se me çfarë mjeti është shkaktuar plaga zhytëse, të dëgjohet drejtpërsëdrejti dëshmitarja P.K. sa i përket veprimeve të të pandehurve në momentin kritik, dhe sipas nevojës dhe rezultatit të provave të ndërmerren edhe veprime tjera që do të kontribuonin në zbardhjen sa më të plotë të çështjes. Pastaj, pasi t'i Aministrojë edhe njëherë të gjitha provat e kësaj çështje, të njëjtat duhet t'i vlerësojë në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.7 të KPP, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave duhen të merren konkludime të drejta dhe të bazuara në provat e Aministruara, e pastaj të merr vendim përkatës në këtë çështje juridiko penale.

Meqë aktgjykimi i kundërshtuar për këtë pjesë të çështjes u dashtë të anulohet për arsye të lartcekura ankesa e Prokurorit dhe ajo e përfaqësuesit të autorizuar e palës së dëmtuar për dënimin për tani janë jolëndore.

Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurve Fa., E. e Ar. është marrë konform dispozitës së nenit 402 par.4 të KPP ngase kjo Gjykatë ka gjetur se akoma qëndrojnë arsye për të cilat kundër tyre është caktuar dhe vazhduar paraburgimi.

2. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pjesën gjykuese përkitazi me të akzuarit E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh., J.K. dhe B.Sh..

1. Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Sa i përket kësaj baze ankimore po thuajse të gjithë mbrojtësit e të pandehurve E.K., M.K., F.K., Nj.K., D.K., I.Sh. e B.Sh. pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar në këtë pjesë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1

nenpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPK, ngase në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë paraqitur arsye mbi faktet vendimtare, kurse arsyet e dhëna janë në kundërshtim me shkresat e lëndës respektivisht provat e Aministruara. Kështu, mbrojtësi i të pandehurit **E.K.** përkitazi me këtë bazë ankimore i konteston konkludimet e gjykatës në bazë të provave të Aministruara duke pretenduar se nga provat e Aministruara nuk mund të konkludohet se i mbrojturi i tij është kryerës i veprave penale për të cilat është shpall fajtor.

Mbrojtësi i të pandehurit **M.K.** në këtë drejtim shton se dispozitivi i aktgjykimit siç është përshkruar nën pikën 1.4 për të mbrojturin e tij është i paqartë, ngase nga dispozitivi nuk rezultojnë veprimet konkrete të të pandehurit, mjetet e përdorura dhe pasojat e shkaktuara. Kështu, në dispozitiv theksohet “...kur i pandehuri Me. e godet të pandehurin I. me një mjet të fortë në shpinë..”, pra, nuk përcaktohet mjeti i kryerjes së veprës penale, ndërsa, kur përshkruhen lëndimet trupore të të dëmtuarit në dispozitiv theksohet” duke i shkaktuar lëndime në kokë, kraharor, nyjën e krahut të majtë në formë brejtjeve të shoqëruara me plagë shqyese pëlcitëse në koke, tronditje trunore thyerje të brinjës së 8 të përcjellë me prani nën lëkurorë të ajrit, prandaj si i tillë aktgjykimi është kundërthënës dhe as që gjykata i ka eliminuar këto kundërthënie.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit **F.K.**, po ashtu pretendon se që të dy dispozitivat e aktgjykimit për veprën penale lëndim i rendë trupor dhe lëndim i lehtë trupor për të cilat është shpall fajtor i mbrojturi i tij janë kundërthënës me përmbajtjen e shkresave të lëndës, sepse nuk janë paraqitur arsye mbi faktet vendimtare përkitazi me veprimet e të pandehurit lidhur me kryerjen e veprës penale, dhe mjetet me të cilat janë shkaktuar lëndimet.

Kurse, mbrojtësi i të pandehurit **Nj.K.** sa i përket kësaj baze ankimore pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.8 të KPK, ngase bazohet në provë të papranueshme. Sipas këtij mbrojtësi, i mbrojturi i tij ka pësuar lëndime të renda trupore dhe nuk ka mundur ta sulmojë askënd. I pandehuri pasi që ka dëgjuar britmat dhe ka dal nga podrumi i shtëpisë është sulmuar dhe nuk ka mundur të ketë asgjë në dorë, prandaj deklaratat e të pandehurve tjerë sidomos e Fa. Sh. se është goditur nga Ni.u nuk qëndrojnë, për çka sipas mbrojtjes aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme.

Mbrojtësit e të pandehurit **D.K.** sa i përket kësaj baze ankimore përveç që pretendojnë se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale, ngase është i paqartë, kundërthënës me brendinë e tij dhe arsyetimin, konsiderojnë se mbështetet edhe në prova të papranueshme. Sepse, gjykata e ka mbështetur aktgjykimin në dëshmitë e personave që kanë qenë të involvuar në cilësi të pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale, dhe nuk janë dhënë arsye përkitazi me saktësinë e provave kundërthënëse. Përveç kësaj sipas tyre dispozitivi i aktgjykimit përkitazi me të mbrojturin e tyre është kundërthënës me vetveten, ngase përderisa në dispozitiv del se D.K. është shpall fajtor për veprën penale “lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 pika 1 të KPK, në pjesën dënuese theksohet për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par. Pika 4 (faqja nr.8, rreshti i katërt). Edhe mbrojtësi i të pandehurit **B.Sh.** sa i përket kësaj baze ankimore pretendon se gjykata nuk ka dhënë arsye mbi faktet vendimtare, dhe se dispozitivi është i paqartë edhe

për faktin se në dispozitiv theksohet se i pandehuri B.Sh. ka marrë pjesë në rrahje por nuk theksohet asnjë veprim i tij. Mbrojtësi i të pandehurit **I.Sh.** nuk e kundërshton aktgjykimin për këtë bazë ankimore. Kurse, mbrojtësi i të pandehurit **J.K.** edhe pse e kundërshton aktgjykimin përkitazi me këtë bazë ankimore nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur, pos që thekson se në dispozitivin e aktgjykimit nuk përshkruhen veprimet të cilat i ka ndërmarrë i mbrojturi i tij dhe në këtë drejtim nuk jep arsye tjera.

Edhe pse përkitazi me këtë bazë ankimore disa nga mbrojtësit e të pandehurve nuk kanë dhënë arsye të qarta se në çka konsistojnë këto shkelje, kurse disa prej arsyeve të dhëna në ankesa me tepër i referohen gjendjes së fakteve, ngase, cilave prova dhe pse gjykata ua ka kushtuar besimin, e cilave jo, ka të bëjë me gjendjen faktike (për çka do të behet fjalë në kuAër të kësaj baze ankimore), e jo përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo Gjykatë e shqyrtoi aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me këto pretendime ankimore edhe konform nenit 394 të KPP dhe konstatoi se aktgjykimi për këtë pjesë të çështjes nuk përmban shkelje esenciale të pretenduara në ankesa e as shkelje të tjera të cilat kjo Gjykatë në instancë të dytë i shqyrton detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Aktgjykimi i kundërshtuar për këtë pjesë të çështjes, pra edhe dispozitivi i tij është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale. Në të vërtetë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar dhe ka dhënë arsye të qarta për vërtetimin e këtillë të fakteve, ka përshkruar rezultatin e procedurës provuese duke arsyetuar se për se disa fakte i merr si të provuara e disa jo. Arsyet e dhëna në aktgjykimin e kundërshtuar janë në harmoni me dispozitivin e aktgjykimit për këtë pjesë të çështjes, ku në mënyrë të qartë dhe konkrete janë përshkruar veprimet inkriminuese të të pandehurve të ndërmarra ditën kritike dhe mjetet me të cilat kanë vepruar. Duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit D.K. se dispozitivi i aktgjykimit përkitazi me të mbrojturin e tij është kundërthënës me vetveten dhe ato të mbrojtësit të të pandehurit M.K. se në dispozitiv të aktgjykimit nuk theksohen veprimet konkrete të të pandehurit, mjetet e përdorura dhe pasojat e shkaktuara kjo Gjykatë vlerëson se ato nuk janë të bazuara. Në fakt është e evidente se në dispozitiv të aktgjykimit sa i përket emërtimit ligjor të veprës penale theksohet se i pandehuri D.K. ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.1 pika 1 të KPK, ndërsa, në pjesën dënuuese theksohet se të pandehurit D. për veprën penale “lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par. 1 pika 4 të KPK i caktohet dënimi..”, por, kjo nuk e bën aktgjykimin juridikisht të paqëndrueshëm, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim të natyrës teknike, sepse, edhe nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese në dispozitiv të aktgjykimit, por, edhe nga arsyetimi del qartë se kemi të bëjmë me veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK. Pastaj, pa bazë pretendohet se në dispozitiv të aktgjykimit nuk theksohen veprimet konkrete të të pandehurit M.K. e Fi., mjetet e përdorura dhe pasojat e shkaktuara. Në fakt edhe pse mjeti me të cilin ka vepruar i pandehuri Me. nuk është përcaktuar saktësisht kjo nuk e bën aktgjykimin e paqartë, e as në kundërshtim me arsyetimin siç pa të drejtë pretendohet në ankesë, ngase nga shkresat e lëndës respektivisht provat e Aministruara, dhe ekspertiza

mjeko ligjore është vërtetuar se lëndimet e shkaktuara të theksuara sikurse në dispozitiv janë shkaktuar me mjet të fortë si copë druri. Duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit Nj.K.. se aktgjykim mbështetët në provë të papranueshme, kjo Gjykatë vlerëson se shkeljet e pretenduara në këtë drejtim jo vetëm që janë të paqarta, por nuk mund vlerësohen ashtu siç pretendon ky mbrojtës. Se pari, me dispozita ligjore – neni 257 të KPP është përcaktuar se kur një provë konsiderohet e papranueshme dhe aktgjykimi nuk mund të mbështetët në të. Së dyti, po ashtu, sipas dispozitave ligjore është përcaktuar se mbrojtja e të pandehurit mund të shërbej si dëshmi (neni 125 par.2 të KPP), në procedurë penale. Ndërsa, sa këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata. Në këtë rast Gjykata e Apelit vlerëson se provat në këtë çështje juridiko penale nuk janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale. Prandaj, duke pasur parasysh këtë dhe faktin se mbrojtja e të pandehurve mund të shërbej si provë në procedurë penale në rastet kur ofrojnë të dhëna për çështjen, pretendimet ankimore të këtij mbrojtësi por edhe të mbrojtësit D.K. se aktgjykimi mbështetët në dëshmitë e personave që kanë qenë të involvuar në cilësi të pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale nuk janë të bazuara.

2. Pretendimet përkitazi me gjendjen faktike dhe shkeljen e ligjit penal

Meqë pretendimet ankimore sa i përket gjendjes faktike i referohen edhe shkeljes së ligjit penal, kjo Gjykatë që të dyja këto baza ankimore do ti vlerësoj si një tersi.

Përkitazi me gjendjen faktike mbrojtësit e të të pandehurve pothuajse të gjithë në këtë drejtim i kontestojnë konkludimet e gjykatës në bazë të provave të Administruara. Në këtë drejtim mbrojtësi i të pandehurit **E.K.** thekson se i mbrojturi i tij është shpall fajtor për lëndimet trupore të shkaktuara në dëm të pandehurit Ni. dhe F.K.t, por gjykata konkludimin e saj përkitazi me fajësinë e tij e mbështet vetëm në dëshminë e anëtareve të familjes N.K., ani pse i akuzuari Be. në hetime ka shpreh dyshime se thika ishte në dorën e He. apo Dt, kurse dëshmitarja V.K. ka deklaruar se nuk e dinte se thika ishte në dorë të He. apo E.K.t, ndërsa, i pandehuri B.Sh. në deklaratën e tij në mënyrë shume të qartë ka deklaruar se thika ishte në dorë të F.K.t dhe me të ka tentuar ta godas Ba., por Ba. duke e mbrojt veten e ia shtyn dorën dhe Fi. gabimisht e godet vëllain e tij Nj.K..n. Ndërsa, për sqarimin e këtij fakti gjykata është dashtë ta dëgjojë dëshmitarin Rr.H..

Mbrojtësi i të pandehurit **M.K.** në këtë drejtim pretendon se konkludimi i Gjykatës përkitazi me fajësinë e të mbrojturit të tij nuk është i bazuar, për faktin se i mbrojturi i tij ka qenë i sulmuar dhe se ka vepruar në mbrojtje të nevojshme. Mbrojtësi i të pandehurit **F.K.**, në këtë drejtim thekson se nga mbrojtjet e të akuzuarve F.Sh., Be., Me., E., J., E. e A.K. dhe B.Sh. nuk del se i mbrojturi i tij është kryerës i veprave penale për të cilat është shpall fajtor, kurse e vetmja dëshmi është deklarata e të pandehurit I.Sh. i cili thekson se “Fi. po ashtu me ka goditur me shishe në kokë”, ndërsa, kjo deklaratë e tij nuk provohet me prova materiale. Ndërsa, mbrojtësi i të pandehurit **Ni. K.** pretendon se në këtë ngjarje i mbrojturi i tij është viktimë, ngase ai pasi që ka dëgjuar britmat dhe ka dal nga podrumi është sulmuar me brisk dhe nuk ka mundur ta lëndoj askënd. Edhe mbrojtësit e të pandehurit **D.K.** në këtë drejtim pretendojnë se gjykata provat i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme duke ia falë besimin

vetëm familjareve të të pandehurit Me., ndërsa, edhe provat materiale nuk janë bindëse, ngase fillimisht në mendimin me shkrim ekspertit ka konstatuar se lëndimi është shkaktuar me një shufër druri, ndërsa, në shqyrtimin gjyqësor thekson se lëndimi është shkaktuar me mjet të mprehtë me maje, ndërsa, për ti evituar dilemat është dashtë të behet super ekspertizë. Mbrojtësi i të pandehurit **I.Sh.** pretendon se nga provat e Aministruara nuk del se i mbrojturi e ka kryer veprën penale ngase ai ka qenë i sulmuar nga personat të cilët kanë qenë të përfshirë në përlëshje të cilët i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, mAjë edhe vet e dëmtuara e mohon faktin se e njëjta të jetë goditur me ndonjë mjet të fortë nga I.i, dhe se veprimet e tij kanë pas karakter mbrojtës. Ndërsa, edhe mbrojtësit e të pandehurve **J.K. e B.Sh.** në këtë drejtim pretendojnë se nga provat e Aministruara nuk rezulton se këta të pandehur të kenë marrë pjesë në rrahje. Meqë, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sipas ankesave të të gjithë mbrojtësve Gjykata e shkallës së parë e ka shkelur ligjin penal kur të pandehurit i ka shpall fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Përkitazi me shkakun që i ka paraprirë kësaj ngjarje që ka rezultuar me përlëshje fizike në mes të të pandehurve, dhe pasojave të saj, është bërë fjalë në pjesën anuluese, prandaj në këtë pjesë të çështjes nuk do behet fjalë. Sipas shkresave të lëndës në këtë çështje nuk është kontestuese se të pandehurit gjatë rrahjes apo përlëshjes fizike i kanë shkaktuar lëndime trupore njeri tjetrit. Po ashtu nuk është kontestuese se në këtë çështje nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes të pa interesuar për çështjen dëshmia e të cilit do të provonte elementet e veprave penale për të cilën ngarkohen të pandehurit, përveç mbrojtjes se të pandehurve dhe dëshmisë se familjarëve të të pandehurve.

Kontestuese për këtë pjesë të çështjes është fakti se a qëndrojnë në veprimet e të pandehurve elementet e veprave penale për të cilat ata janë shpall fajtor.

Kështu, gjykata e shkallës së parë me Aministrimin e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar:

Se i pandehuri E.K. ka marrë pjesë në përlëshjen fizike, dhe gjatë përlëshjes me dashje me një thikë kuzhine e ka goditur të pandehurin **Nj.K.** në regjionin e barkut duke i shkaktuar plagë shpuese-prerëse, lëndim ky i kualifikuar sipas ekspertit të mjekësisë ligjore si lëndim i rëndë trupor. Me akuzë, ky i pandehur është ngarkuar se edhe të pandehurit **F.K.** me po të njëjtën thikë i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në anën e majtë të shpinës duke i shkaktuar plagë prerëse shpuese bazuar në ekspertizën mjeko ligjor të bërë nga Dr.C.M.. Mirëpo, në shqyrtimin gjyqësor mbrojtësi i të pandehurit E. ia ka prezantuar si provë gjykatës ekspertizën mjeko ligjore të bërë nga Dr.T.G., sipas së cilës ekspertizë lëndimet të cilat i ka pësuar i pandehuri Fi. janë kualifikuar si lëndime të natyrës së lehtë. Meqë, ekspertizat kanë qenë kontraktore sa i përket natyrës së lëndimeve, gjykata ka urdhëruar që të behet super ekspertizë, të cilën e ka bërë grupi prej tre mjekëve të cilët janë dëgjuar edhe në shqyrtimin gjyqësor të cilët e kanë mbështetur konstatimin dhe mendimin e tyre të dhënë me shkrim, se plagët prerëse-shpuese në regjionin i dorë të anës së majtë me dimensione 2 cm gjatësi dhe 0.5 cm gjerësi janë shkaktuar nga mjeti mekanik i fortë dhe i

mprehtë që posedon maje dhe teh dhe lëndimet si të tilla klasifikon në lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme. Këtë gjendje të fakteve gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar përpos nga ekspertiza mjeko ligjore dhe super ekspertiza, edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve Gj. e K.K., mbrojtja e të pandehurve Fi., Ni. e M.K.. Bazuar në provat e Aministruara Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka vërtetuar se të pandehurit **Me. e F.K.** kanë marrë pjesë në përleshjen fizike dhe gjatë përleshjes që të dytë me dashje si bashkekzekutor i shkaktojnë lëndime të pandehurit **I.Sh.**, ashtu që i pandehuri Me. e godet me një mjet të fortë në shpinë, ndërsa i i pandehuri Fi. me shishe duke i shkaktuar lëndime në kokë, në kraharor, nyjen e krahut të majtë në formë të brejtjeve, të shoqëruara me plagë shqyerëse pëlçitëse në kokë, tronditje trunore, thyerje të brinjës së tetë të përcjell me prani nën lëkurore të ajrit, lëndime këto që sipas ekspertit mjeko ligjore janë të natyrës së rëndë e që kanë shkaktuar dobësim të përkohshëm të aktivitetit fizik për pjesët e atakuara. Ndërsa, i pandehuri Fi. në bashkëkryerje me të pandehurin **Ni.** gjatë përleshjes fizike të pandehurit **F.Sh.** i shkaktojnë lëndime ashtu që i pandehuri Ni. e godet me një letvë druri në kokë, kurse i pandehuri Fi. me një gyp në tepin e kokës, duke i shkaktuar lëndime në kokë në formë të brejtjeve të shoqëruara me plagë shqyese të cilat sipas ekspertit mjeko ligjore janë të natyrës së lehtë të shoqëruara me dobësim të aktivitetit fizik në pjesën e atakuar. Sipas ekspertizave mjeko ligjore lëndimet të cilat i ka pësuar i pandehuri **I.** janë shkaktuar nga dinamika e veprimit të pjesës mbretëse të mjetit të fortë, të furishëm sulmues mekanik që përkon me rrethanat e çështjes e që mund të jetë copë druri etj, ndërsa, lëndimet që i ka pësuar i pandehuri Fa. janë shkaktuar nga dinamika e veprimet të pjesës mbretëse të mjetit të fortë të furishëm sulmues mekanik që mund të jetë shufër druri. Këtë, gjendje të fakteve sa i përket të pandehurve Me., Fi. e Nj.K.. Gjykata përveç nga ekspertizat mjeko ligjore e mbështet në mbrojtjen e të pandehurve I. e F.Sh.. Faktin se i pandehuri D.K. është involvuar në përleshjen fizike dhe gjatë përleshjes i pajisur me një kaçavidë në dorë e ka goditur me dashje të pandehurin **M.K.** në kokë duke i shkaktuar plagë shquese në regjionin frontal të kokës dhe plagë në formë të kontuzioneve, lëndime këto të kualifikuara sipas ekspertit mjeko ligjor si lëndime të lehta trupore, gjykata e shkallës së parë e vërteton jo vetëm nga ekspertiza mjeko ligjore por edhe nga mbrojtja e të pandehurit Me.. Kurse, faktin se i pandehuri I.Sh. gjatë përleshjes me dashje duke e goditur me grushte i shkakton të dëmtuarës Z. K.t.(motrës së tij) lëndime në anën e majtë dhe të të djathtë të shpatullave në formë të brejtjeve të shoqëruara me infiltrim nën lëkuror të gjakut dhe plagë në dorën e djathtë lëndime këto të kualifikuara sipas ekspertit mjeko ligjore si lëndime të lehta trupore, gjykata e vërteton jo vetëm nga ekspertiza mjeko ligjore dhe dëshmia e të dëmtuarës, por edhe nga dëshmia e dëshmitares Shefkije K.t. Po ashtu, Gjykata nga provat e Aministruara-dëshmia e dëshmitares Z.K., V.K. gjen se të pandehurit J. e B.Sh. marrin pjesë në këtë rrahje.

Është evidente se dëshmitarë të kësaj çështje janë familjaret e të pandehurve, dhe se gjykata ua ka falur besimin dëshmisë së tyre, dhe se këta dëshmitar në dëshminë e tyre, por, edhe të pandehurit në mbrojtjen e tyre nuk kanë pas konsekuencë në të gjitha fazat e procedurës përkitazi me rrjedhjen e ngjarjes, lëndimet e shkaktuara. Mirëpo, pavarësisht kësaj në kontekst të vlerësimit të gjithmbarshëm të provave të Aministruara, veçanërisht mbrojtjes se të pandehurve të cilët janë edhe të dëmtuar, respektivisht kanë pësuar lëndime në këtë ngjarje, faktin se këto lëndime vërtetohen edhe ekspertizat mjeko ligjore kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësve të të pandehurve se gjendja

faktike për këtë pjesë të çështjes nuk është vërtetuar nuk janë të bazuara. Bazuar në mbrojtjen e të pandehurit Me. në fazën e hetuesisë të dhënë menjëherë pas ngjarjes se “ E.i e ka thënë me thikë të kuzhinës vëllain e tij Ni.n në pjesën e poshtme të anës së djathtë të barkut dhe po ashtu edhe Fi.n”, mbrojtjen e të pandehurve Fi. e Ni. dhe dëshmitë e dëshmitarëve tjerë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dëgjimi i dëshmitarit Rr.H. në shqyrtimin gjyqësor nuk do ta ndryshonte gjendjen faktike në këtë pjesë, ngase, ai në dëshminë e tij të dhënë në hetime përpos që ka theksuar se një person ka pas thikë në dorë nuk ka argumentuar diç me shumë në këtë drejtim, prandaj pretendimet e mbrojtësit të pandehurit E.K. në këtë drejtim janë të pabazuara. Po ashtu, të pabazuara janë edhe pretendimet e mbrojtësit të pandehurit D. për super ekspertizë mjeko ligjore, ngase eksperti mjeko ligjore në shqyrtimin gjyqësor nuk ka lenë dilema përkitazi me mjetin të cilin e ka përdorur i pandehuri D.. Kurse, duke pasur parasysh ecurinë se si është zhvilluar ngjarja, rezulton qartë se të gjithë të pandehurit kanë shpreh vullnet që t’i qërojnë hesapet fizikisht, prandaj, nuk mund të behet fjalë për mbrojtje të nevojshme, për çka kjo Gjykatë i vlerëson si të pabaza edhe pretendimet në këtë drejtim.

Nga, arsyet e lartcekura dhe arsyet e dhëna me gjerësisht në aktgjykimin e kundërshtuar Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike përkitazi me këta të pandehur në këtë çështje penale, nga e cila rezulton se në veprimet e të pandehurve përmbahen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat ata janë shpall fajtor, prandaj, janë të pabazuara edhe pretendimet ankimore në drejtim të shkeljes së ligjit penal në dëm të të pandehurve.

c. pretendimet sa i përket vendimit për dënim

Prokurori sa i përket vendimit për dënim pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurve E.K., Me., Ni., Fi., D., e J.K.t, I. e B. Sh. i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese. Sipas prokurores, duke pas parasysh mënyrën e kryerjes së veprave penale, mjetet të cilat janë përdorur, vendosmërinë e të pandehurve për shkaktimin e pasojave, faktin se të pandehurit janë kushërinj të afërt, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve nga gjykata e shkallës së parë nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësive penale të tyre dhe se me dënimet e shqiptuara nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Kurse, që të gjithë mbrojtësit e të pandehurve pretendojnë se dënimet e shqiptuara janë të ashpra dhe në kuAër të rrethanave lehtësuese pretendojnë se edhe me dënime me të buta do të mund të arrihej qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar këto pretendime ankimore dhe aktgjykimin e shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerëson se matja e dënimeve të shqiptuara ndaj të pandehurve me aktgjykimin e kundërshtuar është bërë në pajtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform nenit 73 të KPRK, kështu që dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprës se kryer, përgjegjësinë penale të tyre, dëmtimin e vlerës së mbrojtur, rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale dhe sjelljen e mëparshme të kryesve dhe paraqiten si të nevojshme për t’u arritur qëllimi i dënimit konform dispozitave ligjore.

Disa nga rrethanat e cekura ne ankesat e mbrojtësve të të pandehurve të cilat nuk janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk janë të atilla që do të ndikonin në shqiptimin e ndonjë dënimi më të butë, kurse, as në ankesën e Prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e posaçme rënduese që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër(çuditërisht Prokurori me ankesë e kundërshton aktgjykimin edhe sa i përket të pandehurit I.Sh. e B.Sh. edhe pse atyre ju është shqiptuar maksimumi i dënimit, të cilin fakt përkitazi me të pandehurin I. mAjë vet e thekson në ankesë). Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë Aekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve, dhe se me to do të mund të ndikohet në parandalimin e tyre nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, dhe do të forcojë moralin dhe detyrimin e shoqërisë për respektimin e ligjit, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

III

3. Vlerësimi i Gjykatës për pjesën liruese përkitazi me të pandehurit F.Sh., E.K., A.K., A.K., B.K.1. e B.K..

Siç del nga shkresat e lëndës të pandehurit F.Sh., E.K. e A.K., përveç për veprën penale të vrasjes, nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK, me aktakuze janë akuzuar edhe për veprën penale lëndim i rendë trupor, parashikuar me nenin 154 par.1 pika 4 të KPK të kryer në dëm të fëmijës E.K., kurse A.K., B.K. e B.K.1. për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, parashikuar me nenin 155 par.1 të KPK. Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor vjen në konkludim se nuk është provuar se këta të pandehur i kanë kryer këto vepra penale dhe i liron nga akuza.

Duke e vlersuar aktgjykimin e kundërshtuar në këtë pjesë kjo Gjykatë vlerëson se ankesa e Prokurorit nuk është e bazuar. Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale Prokurori pretendon se aktgjykimi në këtë pjesë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 12 lidhur me nenin 370 të KPP, ngase gjykata nuk ka dhënë arsye mbi faktet vendimtare, ndërsa, arsyet e dhëna janë të paqarta dhe në kundërshtim me provat e Aministruara. Mirëpo, arsyet e dhëna se në çka konsistojnë këto shkelje i referohen gjendjes së fakteve. .

Edhe pse me ankesën e Prokurorit arsyet e dhëna në këtë drejtim i referohen gjendjes së fakteve, kjo Gjykatë megjithatë e shqyrtoj aktgjykimin e kundërshtuar në këtë pjesë sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë dhe as shkelje tjera të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Përkitazi me gjendjen faktike me ankesë vetëm kontestohen konkludimet e gjykatës ne bazë te provave të Aministruara. Kështu, pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, mirëpo, bazuar në faktet e vërtetuara konkludimi i saj se

nuk është provuar se të pandehurit Fa., E. e Ar. nuk e kanë kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, kurse të pandehurit A., Be. e B. veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje është i gabuar. Sipas ankesës së Prokurorit edhe pse sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko - ligjor N.F. gjendja psikike e çrregulluar si pasojë e stresit post traumatik është dëmtim i shëndetit, që sjell deri të paaftësia e përkohshme dhe zvogëlimi i përkohshëm i aftësisë së personit tjetër për të jetuar dhe punuar, të cilin çrregullim të pandehurit ia kanë shkaktuar fëmijës E.K.t, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se Prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë që do ta bindtë gjykatën se të pandehurit janë penalisht përgjegjës për këtë vepër penale. Sipas ankesës konstatimi i Gjykatës së të pandehurit A., B. e Be. edhe pse janë parë në vendin e ngjarjes nuk kanë marrë pjesë aktive në rrahje është i gabuar, sepse të gjithë dëshmitaret kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në rrahje, dhe një fakti i tillë vërtetohet veçmas nga deklarata e N.K.t dhe dëshmia e dëshmitares Z.K.t. Meqë konkludimet e gjykatës në bazë të gjendjes faktike janë të gabuara, sipas Prokurorit ajo e ka shkelur ligjin penal në favor të këtyre të pandehurve kur ata i ka liruar nga akuza.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë edhe këto pretendime nuk janë të bazuara. Sipas dispozitave ligjore veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, nga neni 154 par.1 pika 4 të KPK e kryen kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër që rezulton me paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe të mAh ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar. Pra, sipas kësaj dispozite kjo vepër penale kryhet me dashje atëherë kur ndërmerret veprimi me të cilin personit tjetër i dëmtohet integriteti fizik, mendor dhe shëndetësor.

Sipas shkresave të çështjes dhe provave të Aministruara dalin si jokontestuese këto fakte se fëmija E.K. i moshës 5 vjeçare-djali i të pandehurit B.K., ishte prezent në vendin e ngjarjes gjatë përleshjes fizike në mes të të pandehurve që ka rezultuar me vdekjen e të ndjerit B.K. dhe shkaktimin e lëndimeve trupor të të pandehurve ndaj njeri tjetrit, dhe sipas ekspertit psikiatrik Dr. N.F. tek Ed. është shkaktuar çrregullim në formë të krizës psikike të përcjell me trauma.

Mirëpo, nga provat e Aministruara në këtë çështje rezulton qartë se të pandehurit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim aktiv në drejtim të dëmtimit të integritetit trupor të Ed.t. Edhe në dispozitivin e akuzës nuk theksohet se të pandehurit të kenë ndërmarrë ndonjë veprim, kështu, në dispozitiv ndër të tjera theksohet “.... si bashkëkryerës gjatë kryerjes së aktit të vrasjes të përshkruar si nën pikën I, të akuzuarit me veprimet e tyre i shkaktojnë çrregullim në formë të krizës psikike të përcjella me trauma të rënda fëmijut E.K.t i cili ishte prezent ne momentin e ngjarjes..”

Nisur, nga kjo gjendje çështjes për këtë Gjykatë kontestuese është fakti se me cilat veprime të pandehurit Fa., E. e Ar. i shkaktuan lëndime të rënda trupore Ed.t, a i ndërmorën ata veprimet inkriminuese me qëllim që atij ti shkaktojnë lëndime, dhe a mund të konkludohet se në veprimet e tyre qëndrojnë elementet e kësaj vepre penale vetëm nga fakti se Ed. ishte prezent gjatë ngjarjes?

Duke pasur parasysh elementet e kësaj vepre penale që duhet të përmbushen për ekzistimin e saj, veçanërisht elementin subjektiv-dashjen, faktin se nga provat e

Aministruara del se të pandehurit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të dëmtimit të shëndetit apo shkaktimit të lëndimeve trupore ndaj këtij fëmije, kjo Gjykatë vlerëson se në veprimet e tyre nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale. Vetëm nga prezenca e Ed.t në ngjarje, respektivisht vështrimi i ngjarjes gjatë kryerjes se veprës penale të vrasjes për të cilën ngarkohen të pandehurit, pa u ndërmarr me dashje asnjë veprim në drejtim të dëmtimit të integritetit trupor të tij nuk mund të konkludohet se ata veprimet e tyre inkriminuese i kanë ndërmarrë edhe me qëllim që të këtij fëmiju t'ia dëmtojnë shëndetin mendor. Po ashtu, është evidente se sipas ekspertit psikiatri gjendja psikike e çrregulluar si pasojë e stresit post-traumatik është dëmtim i shëndetit e cila sjell deri të paaftësia e përkohshme dhe zvogëlimi i përkohshëm i aftësisë së personit tjetër. Por, nga ky konstatim dhe mendim i ekspertit nuk mund të konkludohet se të pandehurit e kanë kryer veprën penale, siç pa bazë pretendon prokurori, ngase eksperti në bazë të njohurive shkencore ka dhënë mendimin e tij përkitazi me shëndetin mendor të fëmijës për shkak të perceptimit të ngjarjes.

Edhe pretendimet e prokurorit se të gjithë dëshmitarët e kësaj çështje theksojnë se të pandehurit A., Be. e B. kanë marrë pjesë në rrahje është i pabazuar. Bazuar në provat e Aministruara konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë se këta të pandehur ishin në vendin e ngjarjes, por, nuk është vërtetuar se kanë marrë pjesë në rrahje është i drejtë. Duke pasur parasysh mbrojtjet e të gjithë të akuzuarve, dhe dëshmitë e dëshmitareve në të gjitha fazat e procedurës (N.K. në deklaratën e tij të dhënë në hetime ka deklaruar se “ unë dhe A.i djali i mAh i Jo.t jemi mundu mi nda”, Z.K. në dëshminë e saj në hetime nuk e përmend fare të pandehurin A., kurse në shqyrtimin gjyqësor deklaroi “aty A.K. i ka mbajtur djemtë e mi kishe po i mbrojtë kur janë therë djemtë e mi), kjo Gjykatë vlerëson se me provat e Aministruara nuk është argumentuar **dyshimi i bazuar mirë** se të pandehurit A., Be. e B. kanë marrë pjesë në rrahje.

Vlen të theksohet se as me ankesë nuk theksohet ndonjë provë që e ve në dyshim gjendjen e fakteve, por vetëm kontestohet vlerësimi i provave nga gjykata, duke pretenduar se është dashtë të merret konkludim tjetër (gjykues), mirëpo, për arsyet e lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore në këtë drejtim nuk janë të bazuara dhe se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur të pandehurit A., Be. e B. i ka liruar nga akuza dhe se drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal.

IV

Meqë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë në pjesën refuzuese përkitazi me pandehurit J.K. për veprën penale të vrasjes, nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK dhe lëndim i rendë trupor, nga neni 154 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK dhe N.K.t për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 par.1 të KPK nuk është ushtruar ankesë, në këtë pjesë aktgjykimi është i formës së prerë, prandaj nuk është shqyrtuar.

Nga sa u tha dhe u analizua më lartë në kuptim të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PAKR.nr.606/2014, me 25 shkurt 2015

Procesmbajtësi,
Shaqë Curri

Kryetari i Gjykatës -kolegjit,
1. Salih Mekaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Fllanza KAiu